



## DREJTORIA PER EKONOMI DHE ZHVILLIM

### RAPORT MUJOR

Data: 01-31.05.2017

**PËR:** Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës Lipjan

**KOPJE:** Sefer Tasholli - Nënkyetar i Komunës Lipjan

**NGA:** Latif Ramadani – Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim

#### KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT UDHËHEQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Pagesa e bizneseve (borgji paraprak)	0	
2	Pagesat për ndryshim të biznesit ,mbushja e faturave për pagesë	43.90 €	
3	Biznese të reja të regjistruara	22	
4	Çertifikata të reja dhe me ndryshime	30	
5	Ndryshim të bizneseve, shtim i njësisë së biznesit, shtim i aktivitetit, ndërrim i pronarit, shtim i agjendit,informata.	17	
6	Vertetim që posedon biznes	1	
7	Aktvendime Refuzimi	1	
8	Pagesat e qiras ,mbushja e faturave për pagesë	65.56 €	
9	Faturime për pagesë të qeras mujore dhe vjetore	1	
10	Shuarje të biznesit	2	

-Kemi përfituar një perkrahje financiare nga MTI për ndertimin dhe funksionalizimin e zonës Ekonomike në Kerqevë, faza e dytë projekt i bashkëfinacuar nga MTI dhe Komuna e Lipjanit.

- Konsultime me DPU-në, DSHP dhe Drejtoratin e Prokurimit për fillimin e procedurave të prokurimit për fazën e dytë të Zonës Ekonomike „ Parkun Industrial” në ZK në Qylagë.

-Kemi komunikuar në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësuesit e projektit „Stabiliteti ekonomik i komuniteteve etnike pakicë dhe shumicë në Kosovë “ e njohur si “Projekti –Socio”, nismë e financuar nga “Engagement Global” në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim-BMZ dhe është duke u implementuar nga Fondacioni për Zhvillim të qendrueshëm Ekonomik PREDA Plus, në partneritet me ASB-ën ekipi i Kosovës. Projekti do të implementohet në 11 komuna në mesin e të cilave edhe Komuna e Lipjanit, ndërsa me datën 25.05.2017 kemi marr pjesë në konferencën e organizuar nga ASB e cila është mbajtur në Prizeren, si dhe kemi nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me ASB në Projektin „Socio-Ekonomik”.

- Raporti për pagesën e qerave, sipas kontratave të lidhura për lokalet dhe shfrytëzuesëve të tokave.

-Konsultime të vazhdueshme me zyren për qështje pronsore juridike si dhe me zyren për qështje ligjore.